

VENDIM
Nr. 829, datë 21.10.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH
TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR
PROJEKTIN “PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË SHËNDETËSISË”,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 57/2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin “Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë”, ratifikuar me ligjin nr.57/2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vjenë, Austri, 1020

LINDA VAN GELDER
Drejtore rajonale, e Ballkanit Perëndimor
Evropës dhe Rajonit të Azisë Qendrore

5 tetor 2020

Sh. së Saj, Anila Denaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

E nderuar Zonja Ministre,

Shqipëria: Projekti i Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor
(Huaja nr. 8466 – AL)

Njoftimi për zgjatjen e datës së mbylljes së projektit, rialokimin e të ardhurave nga huaja dhe ndryshimin e
disbursimit
Përqindja e kategorisë 1 (Punimet)

Ne i referohemi Marrëveshjes së Huas, të datës 24 mars 2015, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”)

(Marrëveshja e Huas) për Projektin e lartpërmendur të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor (Projekti); dhe letrës suaj të datës 15 shtator, 2020, në të cilën i kërkonti Bankës që, të: a) zgjasë datën e mbylljes së projektit; b) rialokojë të ardhurat e huas midis kategorive ekzistuese të disbursimeve; dhe c) ndryshojë përqindjen e disbursimit të kategorisë 1 (Punimet) deri në 100% (përfshirë taksat).

Kemi kënaqësinë t'ju informojmë se Banka ka rënë dakord për kërkesën tuaj dhe për këtë arsye: a) vendosi datën 31 dhjetor 2022 si datë të mëvonshme për qëllimet e seksionit IV.B.2 të shtojcës 2 të Marrëveshjes së Huas; b) ndryshoi përqindjen e disbursimit të kategorisë 1 në 100% (përfshirë taksat); dhe c) rialokoi të ardhurat e Huas, siç përcaktohet në tabelën në seksionin IV.A.2 të shtojcës 2 të Marrëveshjes, siç tregohet në shtojcën bashkëlidhur kësaj letre.

Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes së Huas do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Me respekt

Linda Van Gelder

Drejtoreshë rajonale, e Ballkanit Perëndimor

Evropës dhe Rajonit të Azisë Qendrore

/Nënshkrimi/

Për dijeni:

Shkëlqesisë së Saj znj. Ogerta Manastirliu, ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Znj. Adela Xhemali, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Mira Rakacolli, zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Znj. Blerina Dudushi, menaxhere e Projektit HSIP, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Znj. Majlinda Dhuka, zëvendëssekretare e përgjithshme dhe drejtore e përgjithshme e Departamentit për Zhvillimin dhe Qeverisjen e Mirë, CoM

Z. Patrizio Pagano, drejtor ekzekutiv, Banka Botërore

SHTOJCË

Kategoria	Shuma e huas e alokuar (e shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1. Punimet	13.837.382	100%
2. Mallra, shërbime jokëshilluese	12.463.794	100%
3. Shërbime këshillimi, trajnimi dhe kostot operative	5.718.574	100%
4. Tarifa paraprake	80.250	Shumë e pagueshme në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.07 (b) të kushteve të përgjithshme
5. Një normë kufi e interesit ose tavani i 6. normës së interesit	0	Shumë e kërkueshme sipas seksionit 2.08 (c) të kësaj Marrëveshjeje
Shuma e pashpërndarë	0	
SHUMA TOTALE	32.100.000	